



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Prijmljen / Prodato Received / Delivery	21-07-2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPNSHJK	5319/2023		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Anr. 864/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë, dhe Rushit Kajtazi -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A. Nr. 864/2023 të datës 19.06.2023, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi rruga,

kundër organit të punësimit Komuna e Fushë Kosovës, në çështjen juridike " shkelej e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 20.07.2023 mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën A. Nr. 864/2023 të datës 19.06.2023, të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja sipas shkresave të lëndës e punësuar në pozitën Shefe e Bibliotekës në Komunën e Fushë Kosovës, më datë 19.06.2023, me numër protokollit 4824/2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore që Këshilli të obligojë Komunën e Fushë Kosovës, për harmonizimin e koeficientit nga shtatë (7), në koeficientin tetë (8), ndërsa ankuesja pretendon se kompensohet me koeficient shtatë (7) nga data 01.04.2009.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 864/2023 të datës 19.06.2023 e parashtruar nga ankuesit në

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimi i datës 19.03.2012; Ankesë e datës 16.05.2023, drejtuar Drejtorisë së Administratës; E- maili i datës

06.06.2023; Përshkrimi i detyrave të Punës; Lista e pagave prej datës 01.01.2023, deri me datën 31.01.2023; Përgjigje në ankesë e datës 26.06.2023, me numër protokolli 864/2023.

Kolegji për shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses që Këshilli të obligojë Komunën e Fushë Kosovës, që të bëjë ngritjen e koeficientit nga shtatë (7) në koeficientin tetë (8). Por nga shkesat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses

Bazuar në shkresat e lëndës del së ankuesja në bazë të Akt Emërimit të datës 19.03.2012, mbanë pozitën e punës "Shefe e Bibliotekës", në Komunën e Fushë Ksovës, e njëjta me date 16.05.2023 është drejtuar me ankesë Komunës së Fushë Kosovës gjegjësisht Drejtorisë së Administratës, ndërsa këta të fundit me datë 05.06.2023 i janë përgjigj ankueses përmes imellit zyrtar.

Kolegji nisur nga shkresat e lëndës si dhe nga përshkrimi i punës i cili është aprovuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ gjegjeshit Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës, konstaton se ankuesja nuk ka statusin e nëpunëses civile, sepse ankuesja direkt menagjon me punët e përditshme të bibliotekës.

Ndërlidhur me këtë që u tha më lartë, Kolegji ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë gjegjësisht nenin 2 paragrafi 4 ku përcaktohet se: " **4. Nëpunësi i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike.**

Gjithashtu bazuar nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatet për pranim në Shërbimin civil, siç është përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 si dhe nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet së: **Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.**

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr. 864 /2023

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

Ankueses

Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës;

Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Fushë Kosovës;

Arkivit të KPMSHCK-së